



Albanian—Nudging Users to Reference Institutions When Using Public Domain Cultural Heritage Materials

Translation by Agne Dusabe

*The original English version is the authoritative version on which this unofficial translation is based.*

[Nudging Users to Reference Institutions When Using Public Domain Cultural Heritage Materials](#)

# INKURAJIMI I PËRDORUESVE TË REFEROJNË INSTITUCIONET KUR PËRDORIN MATERIALET E DOMENIT PUBLIK

Udhëzimet e Creative Commons

HYRJE

Këto udhëzime ofrojnë ide të projektuese dhe shembuj të zbatimit për institucionet e trashëgimisë kulturore që dëshirojnë të inkurajojnë përdoruesit t'i referohen atyre në lidhje me përdorimin e materialeve të dixhitalizuara të trashëgimisë kulturore në domenin publik në koleksionet e tyre. Udhëzimet u drejtohen institucioneve që ndajnë hapur përmbajtjen e domenit publik dhe mund të jenë me interes për këdo që është kurioz për çështjet e licencimit të së drejtës së autorit në lidhje me objektet dixhitale të trashëgimisë kulturore.

Prapavijë

Juhuu për Kulturën e Hapur!

Institucionet e trashëgimisë kulturore luajnë një rol themelor për komunitetet të cilave u shërbejnë duke u kujdesur dhe ndarë materialet në koleksionet e tyre. Interneti dhe revolucioni dixhital që pasoi kanë nxitur një valë të hapjes së koleksioneve në internet nga shumë institucione, d.m.th., duke i ndarë në masë të madhe ato, në formë dixhitale të qasjes, përdorim dhe ripërdorim pa pagesë dhe pa kufizime ose me pak kufizime të së drejtës së autorit. Siç shpjegojnë shumë ekspertë në serinë tonë Open Culture Voices, hapja mund të çojë në përfitime të panumërta për komunitetet vendore dhe publikun e gjerë. Licencat e Creative Commons (CC) dhe mjetet e domenit publik janë një pjesë thelbësore e realizimit të "hapjes".

Nuk ka licenca CC për lëshimin e riprodhimeve dixhitale të veprave të domenit publik

Një pjesë e madhe e elementeve të trashëgimisë kulturore që janë dixhitalizuar dhe vënë në dispozicion në internet janë në domenin publik: ato nuk mbrohen më ose nuk kanë gëzuar kurrë mbrojtje nga e drejta e autorit dhe mund të përdoren nga kushdo për çfarëdo qëllimi pa lejen e autorit. Në CC ne jemi të bindur: riprodhimet dixhitale besnike të veprave të domenit publik duhet të qëndrojnë në domenin publik - asnjë e drejtë e re autori ose e drejtë e lidhur nuk duhet të lindë mbi binjakun e dixhitalizuar. Në këtë drejtim, licencat CC nuk mund të përdoren për të lëshuar riprodhime dixhitale të veprave të domenit publik, pasi licencat mund të përdoren vetëm në lidhje me përmbajtjen në të drejtën e autorit. Për të ndarë riprodhimet e dixhitalizuara të materialeve të domenit publik, aktualisht rekomandojmë dedikimin e domenit publik (CC0).

“PD BY” - Një praktikë e përhapur, por problematike

E megjithatë, shumë institucione përdorin licenca CC (jo mjete të domenit publik) për të lëshuar riprodhime besnike të materialit të domenit publik. Kjo nganjëherë përmendet me shaka "PD BY". Pse është kjo praktikë kaq e zakonshme? Rezulton se shumë institucione në përgjithësi dëshirojnë të bëjnë të ditur për rolin e tyre në ruajtjen, restaurimin, digjitalizimin, ndarjen dhe në përgjithësi të informojnë mbi trashëgiminë kulturore që ata kujdesen. Dhe ata përdorin licencat CC (të cilat të gjitha kërkojnë atributim - kushti "BY") si një mjet për t'u kërkuar përdoruesve t'i referohen (ose "atribuojnë") ato. Mjetet e domenit publik të CC, në të kundërt, nuk e mandatojnë atributimin. Në fakt, Raporti ynë i Vlerësimit të Nevojave: A janë mjetet e domenit publik të Creative Commons të përshtatshme për sektorin e trashëgimisë kulturore? zbulon se nevoja kryesore e paplotësuar me mjetet e domenit publik CC është që institucionet të marrin "kredi" kur materiali nga koleksionet e tyre ripërdoret dhe ndahet — rreth 53% e institucioneve që u përgjigjën duan një mënyrë për të siguruar që përdoruesit t'i "kreditojnë" ato.

Një normë për ndarjen më të mirë të materialeve të domenit publik

Jemi në dijeni se administrimi i një numri të koleksioneve nga institucione rrjedh prej konteksteve komplekse historike dhe ligjore. Statusi i së drejtës së autorit të një objekti nuk është aspak mënyra e vetme për të përcaktuar qasjen dhe mundësitë e përdorimit, e lëre më përcaktimin e pronësisë ose kujdestarisë së ligjshme, siç kemi thënë në lidhje me ndarjen e hapur të trashëgimisë kulturore indigjene.

Referencimi i institucioneve bartëse përmes licencave të CC-së nuk këshillohet

Në përgjithësi ne simpatizojmë institucionet që dëshirojnë atributim kur përdoren objekte dixhitale të domenit publik nga koleksionet e tyre dhe që përdoruesit "të atribuojnë aty ku duhet". Megjithatë, ne këshillojmë fuqishëm kundër përdorimit të licencave CC për ta arritur këtë në praktikë për katër arsye kryesore:

- krijon paqartësi për statusin e të drejtës së autorit të materialit;
- është çorientuese dhe krijon konfuzion për përdoruesit në lidhje me qasjen dhe kushtet e përdorimit të materialit;
- krijon një situatë ku licencat janë të pavlefshme, joefektive dhe të pazbatueshme;
- Jo domosdoshmërisht dërgon në përmendje të institucionit, pasi udhëzimet tona të atributimit dhe licencat kërkojnë vetëm përmendjen e titullit, autorit ose krijuesit, licencës dhe burimit të veprës së të drejtës së autorit (zakonisht një URL).

Çfarë duhet të bëjnë institucionet?

Në vitin 2022, një grup punues për Platformën e Kulturës së Hapur të CC, i udhëhequr nga Deborah De Angelis (CC Itali) dhe Tomoaki Watanabe (CC Japoni) hulumtuan këtë çështje në detaje dhe zhvilluan propozime për ndërhyrje teknike, ligjore dhe sociale për të adresuar problemin e “PD BY.”

Tani, të frymëzuar nga ndërhyrja sociale e grupit punues, ne kemi zhvilluar ide të thjeshta projektimi për t'u treguar institucioneve bartëse se si mund të lehtësojnë dhe nxisin njerëzit që përdorin materiale të licencuara hapur ose të domenit publik për t'iu referuar atyre. Duke përdorur modelin [Behavioural Insights Team's EAST Model](#) - një kornizë e thjeshtë për të krijuar ndryshim të sjelljeve ose për të inkurajuar rezultate të caktuara përmes "nxitjes" - ne ofrojmë disa mënyra që institucionet të sigurojnë një "deklaratë referimi" gjithëpërfshirëse, nëse dhe ku është e përshtatshme. Këto ide për përvojën e përdoruesit mund të përdoren në lidhje me licencat dhe mjetet CC. Edhe pse ne nuk ofrojmë udhëzime teknike me kodin HTML/CSS se si të zbatohen veçoritë e propozuara, shpresojmë që ky burim t'i pajisë institucionet me një plan të projektimit që ata mund ta zbatojnë në mjedisin e tyre teknologjik.

Udhëzimet Creative Commons për referencë të institucionit

Çfarë informacioni duhet të përfshihet?

Një deklaratë e përshtatshme duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

Titulli

- Autorja/i ose Krijuesja/i
- Licenca ose Lejet
- Institucioni
- Burimi

Për shembull:

Ocean Coast nga Maurice Denis, Shenjë e Domenit Publik

Muzeu Nacional i Suedisë

<https://collection.nationalmuseum.se/eMP/eMuseumPlus?service=ExternalInterface&module=collection&objectid=23187>

Si mund të nxiten përdoruesit nga institucionet?

Institucionet mund të nxisin ose inkurajojnë përdoruesit e tyre që t'u referohen duke përdorur modelin EAST të Behavioral Insights Team's:

- Lehtë - Lehtësoni referimin për njerëzit.
- Tërheqës - Bëjeni atë diçka që ata duan të bëjnë.
- Sociale - Lidhni veprimin me vlerën shoqërore.
- Në kohë të duhur — Jepni informacion në momentin e duhur.

Për ta përmbledhur, këto janë mënyrat e thjeshta dhe strategjike se si institucionet mund të aplikojnë modelin EAST:

Si të lehtësohet:

Aktivizo një klikim për të kopjuar referencën

Thekso automatikisht tekstin e referencës

Si ta bëni tërheqës:

- Thuaj falemnderit për përdorimin e artikullit
- Qartësoni informatën për përdoruesit
- Jepni të gjitha informacionet në të njëjtën kohë

Si ta bëni sociale:

- Shpërdani numrin e shkarkimeve
- Shpërdani numrin e kopjimit të informacionit të referencës
- Tregoni një shembull të një referimi të përshtatshëm
- Ftoni përdoruesit të përfshijnë institucionin në mediat sociale
- Ndërtoni besimin duke treguar burimin

Si ta bëni në kohë të duhur:

- Aktivizoni një dritare pop-up kur artikulli shkarkohet
- Jepni referencën me dokumentin e shkarkuar
- Dërgoni referencën me email
- Siguroni llogaritë e përdoruesve për të ruajtur gjurmët e shkarkimeve nga përdoruesve

Si do të dukej një nxitje në praktikë?

Në këtë pjesë ne ofrojmë katër ide projektuese se si mund të duken këto strategji në praktikë:

1. Një buton "kopjoni".
2. Një "pop-up" automatik
3. Një opsion i shkarkimit të tekstit të dokumentit
4. Një profil përdoruesi që mban një regjistrim të shkarkimit

Funksionalizimi: Organizmi i të dhënave për projektim

Në këtë pjesë ne ofrojmë shembuj të kornizave të kufizuara (të gjitha funksionojnë brenda JSON-LD) dhe platformave që ofrojnë struktura të përshtatshme për ti përfshirë fjalitë e referimit.

Çfarë është JSON-LD?

JSON-LD është një format i lehtë i të dhënave të lidhura. Të dhënat e lidhura fuqizojnë njerëzit që publikojnë dhe përdorin informacione në ueb. Është një mënyrë për të krijuar një rrjet të të dhënave të bazuara në standarde të lexueshme nga kompjuteri nëpër faqet e internetit. JSON-LD është e lehtë për t'u lexuar dhe shkruar nga njerëzit dhe bazohet në një format tashmë të suksesshëm JSON. Kjo ofron një mënyrë për të ndihmuar të dhënat JSON të ndërveprojnë në nivelin e uebit. JSON-LD është një standard në të gjithë shembujt e platformës më poshtë

dhe rekomandohet nga mjeteve kryesore të kërkimit dhe përdor Identifikuesit e Burimeve të Ndërkombëtarizuara (RDI-të).

Kornizat e të dhënave

Schema.org "Puna krijuese"

Schema.org është një aktivitet bashkëpunues, komuniteti me mision për të krijuar, mirëmbajtur dhe promovuar skema për të dhëna të strukturuar në internet. Skemat janë një grup "llojesh", secila e lidhur me një grup karakteristikash, të cilat janë të renditura në një hierarki. Është alternativa më e mirë për tu shfaqur apo zbuluar në mjetet e kërkimit.

Lloji "CreativeWork" ka veti të shumta duke përfshirë:

- Emrin (titulli)
- Autorin dhe Krijuesin
- Licencën dhe Strukturën e të Dhënave Licencë
- Botuesin
- URL
- Njoftimin për të drejtën e autorit dhe referimin

Këto veti bëjnë të mundur strukturimin e të dhënave të një koleksioni në një mënyrë standarde dhe të lexueshme nga kompjuteri. Të dhënat hyrëse mund të përdoren për të mbushur një karakteristikë tjetër, p.sh., njoftimin për të drejtën e autorit ose referimi i pronësisë.

IIIF "Deklarata e kërkuar"

Korniza Ndërkombëtare e Ndërveprimit të Imazhit (IIIF) është një standard botëror për menaxhimin e koleksioneve dhe përdoret gjerësisht nga institucionet e trashëgimisë kulturore në mbarë botën.

"RequiredStatement" i IIIF është teksti që duhet të shfaqet kur prezantohet ose përdoret një artikull. Për shembull, prona "RequiredStatement" mund të paraqesë deklaratë të së drejtës së autorit ose të pronësisë, si dhe referon tek institucioni zotëruar dhe/ose botues, ose çdo tekst tjetër që konsiderohet kritik për t'u shfaqur për përdoruesit.

"Cookbook" i IIIF për deklaratën e të drejtave ofron udhëzime dhe instruksione të kodit.

Creative Commons rekomandon që institucionet të përfshijnë në "RequiredStatement" të gjithë informacionin që ata dëshirojnë t'i referohen përdoruesit. Kjo përfshin titullin, krijuesin ose autorin, emrin e institucionit ofrues, statusin e të drejtës së autorit, licencën ose mjetin e domenit publik dhe burimin.

Një shënim mbi ccREL

Gjuha e shprehjes së të drejtave të Creative Commons (ccREL) është standardi i Creative Commons për shprehjen e kushteve të licencimit të të drejtave të autorit dhe informacionit të lidhur, e lexueshme nga kompjuteri. ccREL bazohet në World Wide Web Konsorciumin e kornizës së përshkrimit të burimit (RDF). Kjo u propozua në vitin 2008 dhe mbështetja për standardin është zvogëluar ndjeshëm që atëherë. ccREL nuk rekomandohet më për

zbulim në mjete të kërkimit. Për zbulim në mjete të kërkimit, ne rekomandojmë përdorimin e Schema.org "CreativeWork".

## Shpërndarja e platformave

Ka mjaft platforma në të cilat institucionet mund të dëshirojnë të shpërndajnë objekte dixhitale nga koleksioni i tyre. Këtu janë dy prej tyre, të cilat tashmë zbatojnë disa nga idetë e projektimit të paraqitura në këto udhëzime.

## Europeana

Europeana është një grumbullues i koleksioneve të trashëgimisë kulturore europiane. Kjo platformë përdor API-të e hapura dhe mjete të tjera për të mbledhur informacion mbi koleksionet dixhitale dhe për t'i ofruar botës qasje dhe drejtim në koleksionet e dixhitalizuara të Evropës.

Platforma u ofron përdoruesve një deklaratë kur ata shkarkojnë një artikull. Deklarata është e mbushur me informacion nga institucioni që ofron dhe është pjesë e meta të dhënave minimale të kërkuara për të kontribuar në Europeana —që aktualisht përfshin një referencë për institucionin që ofron. Deklarata ndjek formatin: [titulli] nga [krijuesi] - [viti] - [ofruesi], [vendi] - [Deklarata e të drejtave].

## Wikimedia Commons

Wikimedia Commons është koleksioni i koleksionit mediatikë të lëvizjes Wikimedia, që përfshinë imazhe, tinguj dhe video. Kjo u siguron përdoruesve një deklaratë kur ngarkuesi e ka shtuar atë në meta të dhënat e artikullit. Njoftimi i atribuimit mund të shkruhet ose të plotësohet duke përdorur informacionin e meta të dhënave dhe të përfshijë titullin e artikullit, krijuesin, institucionin botues dhe licencën e të drejtës së autorit ose mjetin e domenit publik. Kjo përfshihet më së miri në pjesën "Fusha të tjera = {{Linja krediti}}".

## Mbështetje shtesë

A jeni gati të provoni njëri nga këto projekte? A keni komente se si të zgjerohen apo përmirësohen këto udhëzime, veçanërisht në aspektet teknike? Dëshironi të ndihmoni që ky burim të jetë i disponueshëm në gjuhë të tjera?

- Na kontaktoni në [info@creativecommons.org](mailto:info@creativecommons.org)
- Bashkohuni me Platformën e Kulturës së Hapur për t'u angazhuar me bashkëmoshatarët
- Regjistrohuni për procesin tonë të përkthimit vullnetar

## Falemnderimet

Këto udhëzime janë përgatitur nga Connor Benedict, Koordinator i Open Culture, dhe Brigitte Vézina, Drejtoreshë e Politikave dhe Kulturës së Hapur, Creative Commons. Ka përfituar nga reagimet e dobishme nga anëtarët e grupit të punës të Platformës së Kulturës së Hapur, të udhëhequr nga Deborah De Angelis (CC Itali) dhe Tomoaki Watanabe (CC Japoni) si dhe anëtarë të tjerë të komunitetit të Creative Commons dhe stafi i Creative Commons, për të cilët autorët janë jashtëzakonisht mirënjohës.

## Atribuimi për imazhet:

- Ndarja e koleksioneve të domenit publik CC-BY ?!!!? nga Brigitte Vézina është një remix i "The Scream" nga Edvard Munch (1893), Public Domain, Muzeu Kombëtar Oslo. Licencuar CC-BY SA 4.0

- Download nga Andi wiyanto nga Noun Project (CC BY 3.0)
- Zoomin nga Andi wiyanto nga Noun Project (CC BY 3.0)
- Ocean Coast nga Maurice Denis, Marka e Domenit Publik, Muzeu Kombëtar Suedez